

	Republika e Kosovës Republika Kosovo/ Republic of Kosovo Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor Prokuroria Speciale / Specialnog Tuzilastva / Special Prosecution	
---	---	---

STRATEGJIA E KOMUNIKIMIT PËR PROKURORINË SPECIALE TË KOSOVËS

Udhëzime për forcimin e aktivitetit dhe praktikës –
komunikime proaktive, reaguese dhe në krizë

PËRMBAJTJA

1. Qëllimi i strategjisë	3
2. Cilat janë sfidat kryesore të jashtme të PSRK-së?	4
3. Zgjidhjet gjithëpërfshirëse: në parim	5
4. Prioritetet aktive të PSRK-së – fushat që kërkojnë vëmendje të menjëhershme	7
A. Mesazhet kyqe	7
B. Neutraliteti tonal.....	9
C. Efikasiteti i medieve	9
5. Zgjidhjet: në praktikë	11
A. Punët e zakonshme	11
B. Komunikimet reaktive: përgjigje ndaj sulmeve dhe dezinformimit.....	16
C. Komunikimi i rasteve të ndjeshme dhe të profilit të lartë.....	20
<u>-</u> Udhëzues hap pas hapi: trajtimi i komunikimeve të ndjeshme, të rasteve të profilit të lartë	22
<u>-</u> Pyetje sfiduese: trajtimi i pyetjeve të padëshiruara nga gazetarët	25
D. Krizat dhe komentet në raste emergjente	26
SHTOJCA 1	33
SHTOJCA 2.....	38
SHTOJCA 3.....	40
SHTOJCA 4.....	41

HYRJE

1. Qëllimi i strategjisë

Çfarë adreson strategjia?

Kjo strategji ofron hapa praktik për përmirësimin e aktivitetit dhe sistemeve të komunikimit të PSRK-së, me qëllim që komunikimet e saj të mbështesin objektivat strategjike të zyrës. Strategjia mund të përditësohet dhe modifikohet me kalimin e kohës, për të siguruar relevancën dhe aplikueshmërinë e saj.

Strategjia ofron udhëzime për realizimin e komunikimeve proaktive, transparente dhe profesionale, të cilat paraqesin punën e PSRK-së në një dritë pozitive dhe të vazhdueshme për mediat dhe publikun. Pavarësisht se përfshihen parime të përgjithshme për realizimin e aktiviteteve të komunikimit me standarde të larta në mënyrë të rregullt, kjo strategji fokusohet kryesisht në angazhimin e medias në një kontekst komunikimi të ndërlikuar, duke adresuar sulmet nga palët e jashtme dhe duke menaxhuar komunikimin në rastet e profilit të lartë ose në situata krize.

Për kë është strategjia?

Strategjia do t'i shërbejë qëllimit të saj themelor praktik për zyrtarin për komunikim të PSRK-së, zëdhënësin dhe ekipin e gjerë të komunikimit. Zëdhënësi do të mbështetet në udhëzimet e strategjisë për të formësuar objektivat e komunikimit, infrastrukturën dhe praktikën për PSRK-në në tërësi, dhe do të jetë përgjegjës për zbatimin e strategjisë. Për shkak se, megjithatë, të gjitha komunikimet e PSRK-së kërkojnë gjithashtu mirëkuptimin, mbështetjen dhe kontributin e stafit në të gjithë institucionin, kjo strategji gjithashtu përshkruan se si rolet e tjera mund të marrin pjesë në mënyrë produktive në këtë proces.

Udhëheqja e komunikimit të PSRK-së mbështetet në informacionet që ofrohen nga prokurorët dhe stafi tjetër i PSRK-së, kryesisht nga udhëheqësit e departamenteve, kryeprokurori i PSRK-së dhe administratori. Kjo strategji ka për qëllim sigurimin e një procesi efikas, nëpërmjet të cilit këto pozita mund të mbështesin zëdhënësin (duke pasur parasysh kërkesat e kohës), duke garantuar që ai të jetë gjithmonë i pajisur për të vepruar në mënyrë proaktive dhe të pavarur, të njohur me zhvillimet kryesore dhe materialet përkatëse, dhe kështu të jetë i përgatitur mirë për të drejtuar aktivitetet e komunikimit me vendosmëri, saktësi dhe ndikim. Në këtë kontekst, strategjia gjithashtu synon të mundësojë një proces të shpejtë nënshkrimi në fazën përfundimtare të miratimit nga Kryeprokurori Special, duke siguruar që komunikimet që arrijnë në tryezën e udhëheqësit për shqyrtim të jenë të plota, të informuara dhe të strukturuar siç duhet.

2. Cilat janë sfidat kryesore të jashtme të PSRK-së?

Ky seksion zgjeron diskutimin mbi sfidat kryesore të identifikuara në mënyrë të shkurtër në seksionin katër, (të cilat përbëjnë fokusin e kësaj strategjie dhe janë probleme që nuk mund të adresohen me sukses pa një qasje të strukturuar dhe efektive të komunikimit profesional).

- Organet tjera shtetërore
 - Agjendat politike dhe të shprehurit e tyre të shpeshtë (në pikën e sulmeve të hapura dhe armiqësore nga departamentet e qeverisë, etj.) në media bëjnë që SPRK të jetë shpesh objekt i kritikave publike, të cilat janë të motivuara nga angazhimet politike, dhe jo nga efektiviteti i punës së këtij institucioni. Kjo negativisht formon opinionin publik me akuza që nuk janë të vërtetuara.
- Media
 - Mediat nuk janë plotësisht të pavarura ose të rregulluara siç duhet, gjë që krijon hapësirë për raportime të pasakta ose raportime të njëanshme përgjatë linjave të interesit politik ose komercial.
 - Përderisa disa media të specializuara janë shumë mirë të informuara për drejtësinë penale dhe sistemin ligjor, mediat e gjera kanë njohuri të pakta për funksionet, përgjegjësitë, kompetencat dhe arritjet e PSRK-së, gjë që gjithashtu çon në raportim të pasaktë.
 - PSRK-ja është e kufizuar nga detyrat për të fshehur dhe mbajtur informacione të caktuara (përfshirë, për shembull, detaje rreth rasteve në vazhdim), por disa media besojnë se komunikohet më pak se sa duhet.
- Shoqëria civile
 - Megjithëse marrëdhëniet me organizatat e shoqërisë civile janë të zhvilluara mirë, disa lidhje mund të forcohen për të shmangur konfuzionin rreth gatishmërisë për t'u angazhuar, bashkëpunuar dhe komunikuar nga të dyja palët.
 - Disa organizata të shoqërisë civile janë organe mediatike dhe OJQ të kombinuara, që do të thotë se mediat udhëhiqen nga agenda e OJQ-së, e cila ndërhyr në raportimin neutral.
- Qytetarët
 - Shumica e qytetarëve nuk kanë shumë njohuri për funksionet, përgjegjësitë, kompetencat dhe arritjet e PSRK-së, gjë që çon në pritshmëri konfuze dhe nivel të ulët besimi dhe mbështetje.

3. Zgjidhjet gjithëpërfshirëse: në parim

Të gjitha komunikatat e lëshuara nga PSRK për publikun ose mediat, në çfarëdo formati, në çdo kohë për cilëndo temë, duhet të synojnë të marrin kontrollin e narrativës në domenin publik dhe duhet të mbështeten nga parimet e mëposhtme:

- Neutralitet
- Kredibilitet
- Autoritet
- Pavarësi
- Transparencë

Dhe për të realizuar këto përpjekje, duhet të arrihen sa vijon:

- Sigurimi i qartësisë, standardizimit dhe implementimit të vazhdueshëm të proceseve të komunikimit të brendshëm dhe të jashtëm.
- Hartimi dhe komunikimi i mesazheve të rëndësishme, duke përfshirë sqarimin e rolit dhe qëllimit të PSRK-së për të rritur ndërgjegjësimin dhe mirëkuptimin e publikut.
- Shpërndarja e ndikimit dhe progresit të arritur nga PSRK-ja përmes mediave dhe kanaleve të tjera për të mbështetur mesazhet e qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, duke komunikuar paanshmërinë dhe efikasitetin e PSRK-së.
- Mbështetje për proceset dhe aktivitetet duke përdorur raste studimore dhe praktika të mira.
- Ofrimi i trajnimeve për stafin e komunikimit të PSRK-së për zhvillimin dhe zbatimin e proceseve, hartimin dhe shpërndarjen e komunikatave, menaxhimin e mediave dhe kanaleve sociale.
- Forcimi i marrëdhënieve dhe angazhimit me mediat.
- Kryerja e vlerësimeve vjetore të aktiviteteve të komunikimit, duke përfshirë matjen e rezultateve, ndikimit dhe përgjegjësi të stafit për monitorimin dhe vlerësimin e proceseve.

KOMUNIKONI RREGULLISHT & NË MËNYRE PROAKTIVE	Komunikimi me publikun dhe mediat rreth aktivitetit të PSRK-së duhet të jetë i rregullt, proaktiv, i përgjegjshëm dhe në kohë.
RUAJNI NEUTRALITETIN TONAL	Toni, gjuha dhe formati i përdorur për të komunikuar duhet të përcaktohen varësisht nga audienca, por PSRK-ja duhet t'i përmbahet gjithmonë parimit kryesor të neutralitetit tonal. Me fjalë të tjera, komunikimi i PSRK-së duhet të artikulohet gjithmonë në gjuhë të qetë, profesionale, formale dhe jo emocionale.
MBAJTJA TRANSPARENCA	PSRK duhet të jetë transparente kudo që është e mundur për aktivitetin dhe progresin e saj.

PROCESET STANDARDIZUESE	Për të demonstruar paanshmëri, duhet të zhvillohen procese standarde për komunikim të rregullt dhe të njëjtat hapa duhet të ndiqen çdo herë nga PSRK.
RRITJA E NJOHURIVE DHE VETËDIJZIMIT TË PUBLIKUT	Komunikimi i PSRK-së me publikun dhe mediat duhet të rrisë vetëdijen rreth kërcënimit, të dënojë krimin, të nxjerrë në pah aftësinë e PSRK-së për adresimin e kërcënimit dhe të inkurajojë qytetarët që të njohin dhe raportojnë krimin.
PËRFSHINI MESAZHET THEMELORE	Përmbajtja e të gjitha komunikimeve të PSRK-së duhet të bazohet dhe të shprehë mesazhet kyçe të PSRK-së. Ato duhet të ofrojnë bazat për çdo komunikim dhe duhet të përfshihen dhe të shprehen qartë kudo që të jetë e mundur.
EFIKASISTETI I MEDIEVE	Gazetarët, redaktorët dhe mediat në përgjithësi punojnë me afate të caktuara dhe shpesh të ngushta. Ata mund të publikojnë mesazhe që PSRK-ja dëshiron të shpërndajë vetëm nëse marrin informacionin e kërkuar brenda kohës së përcaktuar. Ato do të bashkëpunojnë me PSRK-në vetëm nëse e shohin se ky institucion e kupton dhe respekton nevojën për të qenë të shpejtë dhe të qartë në komunikim. Për këtë arsye, për të krijuar marrëdhënie të frytshme me mediat dhe për të përdorur platformat e tyre në shërbim të qëllimeve të PSRK-së, stafi i PSRK-së duhet të jetë sa më i komunikueshëm dhe efikas kur ndan informacion me median ose përgjigjet ndaj kërkesave të tyre.

4. Prioritetet aktive të PSRK-së – fushat që kërkojnë vëmendje të menjëhershme

PSRK duhet të fokusohet në:

- A. Mesazhet Kyçe
- B. Neutraliteti Tonal
- C. Efikasiteti i Mediave

A. MESAZHET KYQE

Të gjitha komunikatat e jashtme të lëshuara nga PSRK-ja duhet të jenë në përputhje me objektivat e saj. Komunikimet e jashtme duhet të përmbajë maksimumi tre mesazhe kyçe, të cilat duhet të shprehen në rendin e duhur të prioritetit. Për pjesë e komunikimit të jashtëm duhet të përmbajë mesazhet kyçe të cilat duhet të përshtaten sipas rastit i cili komunikohet. Për të arritur një efikasitet më të lartë, PSRK-ja mund të zhvillojë një grup mesazhesh kyçe që do të shërbejnë si udhëzime bazë, të cilat më pas mund të personalizohen për nevojat e çdo komunikimi të jashtëm.



MESAZHET KYÇE TË PSRK-së

PSRK: ÇFARË BËN?

Detyra kryesore e Prokurorisë Speciale të Kosovës është luftimi i krimit të organizuar dhe nxjerrja para drejtësisë e autorëve të krimit të rëndë dhe të organizuar, korrupsionit dhe krimit financiar, terrorizmit dhe krimeve të luftës.

PSRK: ZBATIMI I LIGJIT

PSRK-ja shërben për forcimin e themeleve të shtetit ligjor dhe të sundimit të ligjit.

PSRK: MBROJTJA E QYTETARËVE

PSRK punon në interes të publikut dhe merr vendime ekskluzivisht në përputhje me standardet etike dhe profesionale, kushtetutën dhe rregulloret ligjore.

PSRK: E PAANSHME DHE E PAVARUR

Për PSRK-në nuk ka persona të paprekshëm apo të mbrojtur. Kushdo që është i përfshirë në krimin e organizuar ose që kryen një vepër penale e cila bie nën kompetencën e PSRK-së, do të jetë në shënjestër të PSRK-së, pavarësisht nga emri, mbiemri, pozicioni, përkatësia tregtare apo politike e personit.

PSRK: TRANSPARENT & I HAPUR

PSRK komunikon në mënyrë të qartë, transparente, objektive dhe në kohën e duhur me të gjithë anëtarët e publikut që janë të interesuar për punën e saj.

PSRK: EFIKASE DHE EFEKTIVE

PSRK punon për të garantuar sigurinë e të gjithë qytetarëve përmes mbrojtjes efikase dhe cilësore të sigurisë së tyre dhe të drejtës së tyre për të jetuar në një shoqëri të lirë nga krimi i organizuar, korrupsioni i nivelit të lartë, pastrimi i parave, krimet e luftës dhe terrorizmi.

PSRK: MBËSHTETJA & FUQIZIMI I VIKTIMAVE

PSRK-ja fuqizon qytetarët që të mbrohen nga viktimizimi duke i mbështetur ata që të njohin dhe raportojnë krimin e organizuar. Të gjitha viktimat duhet të marrin informacion të qartë, në kohë dhe të saktë dhe duhet të trajtohen në mënyrë të drejtë, të duhur dhe me dinjitet.

B. NEUTRALITETI TONAL

Toni, gjuha dhe formati i përdorur për të komunikuar duhet të përcaktohen varësisht nga audienca, por PSRK-ja duhet t'i përmbahet gjithmonë parimit kryesor të neutralitetit tonal. Me fjalë të tjera, komunikimi i PSRK-së duhet të artikulohet gjithmonë në gjuhë të qetë, profesionale, formale dhe jo emocionale

Modelet për përgjigjet në të folur dhe shkruar ofrohen në seksione të ndryshme të strategjisë, së bashku me një analizë të detajuar në Shtojcën 2 për gjuhën e përdorur më parë që ndoshta është tepër emocionale.

C. EFIKASITETI I MEDIEVE

Rritja e angazhimit. Mediat kosovare janë të angazhuara dhe investuara në aktivitetin e PSRK-së dhe do të mirëprisnin më shumë komunikim rreth punës së Zyrës.

Komunikoni vazhdimisht. Shkëmbimi i rregullt dhe i paanshëm i informacionit do të ndihmojë në krijimin e reputacionit të PSRK-së dhe do të demonstrojë neutralitetin e saj. Komunikoni kur informacioni mund dhe nuk mund të ndahet me transparencë, dhe se kur mund të informohet media. Nëse afati kohor është i panjohur, komunikojeni edhe këtë për qëllime transparence.

Komunikoni në mënyrë efikase: Për të ndërtuar marrëdhënie të efektshme me mediat dhe për të shfrytëzuar kanalet e tyre në përmbushjen e objektivave të PSRK-së, stafi i PSRK-së duhet të jetë i aftë të komunikojë në mënyrë të qartë dhe efikase. Gazetarët, redaktorët dhe mediat punojnë me afate të caktuara dhe shpesh të ngushta, dhe shpërndarja e informacionit nga PSRK-ja mund të realizohet vetëm nëse kërkesat e nevojshme janë dhënë brenda këtyre afateve. Bashkëpunimi me mediat është i mundur vetëm kur ato e vlerësojnë që PSRK-ja kupton dhe respekton nevojat e tyre. Për këtë arsye, është e rëndësishme që stafi i PSRK-së të sigurohet që komunikimi me median të jetë i shpejtë, korrekt dhe të jetë në kohë.

- Nëse historia për të cilën gazetari po punon mund të ndihmojë në përhapjen e mesazheve kryesore të PSRK-së, zëdhënësi duhet të sigurohet që gazetarët të kenë gjithmonë prioritet dhe t'u ofrohen informacionet që u duhen, në momentin që i kërkojnë.
- Nëse historia që gazetari po punon nuk ka ndikim pozitiv as negativ për PSRK-në, zëdhënësi duhet të përpiqet t'i ofrojë gazetarëve informacionin që kërkojnë, për të forcuar marrëdhëniet me gazetarin/median.
- Nëse historia mund të dëmtojë imazhin e PSRK-së, zëdhënësi duhet të sigurojë që gazetarëve t'u ofrohen informacionet korrigjuese ose faktet e rëndësishme përpara afatit, edhe nëse gazetari nuk i ka kërkuar ende.
- Nëse është e vështirë të ofrohet informacioni i nevojshëm për gazetarin brenda afatit të caktuar, ose nëse nuk është e mundur, zëdhënësi duhet të komunikojë me gazetarin për këtë, duke e mbajtur atë të informuar për çfarë është e mundur dhe për statusin e procesit. Për shembull, "Nuk mund ta ndajmë X tani, por mund të ndajmë Y. Do të mund ta kemi atë për ju deri në kohën X, por do të qëndroj në kontakt nëse ka vonesa dhe do t'ju mbaj të përditësuar."

Pasi interesimi i një gazetari për një histori mund të ofrojë mundësinë për të theksuar mesazhet kryesore të SPRK-së, ose për të kufizuar dëmet, ose për të ndërtuar një marrëdhënie që mund të jetë e dobishme për SPRK-në në të ardhmen, është e rëndësishme që gazetarët të mund të kontaktojnë lehtësisht zëdhënësin. Çdo komunikim i dërguar nga SPRK (qoftë përmes email-it apo në faqen e internetit) duhet të përmbajë detajet e kontaktit të zëdhënësit – një adresë emaili dhe një numër telefoni direkt. Këto pika kontakti duhet të monitorohen ngushtë nga zëdhënësi.

Gazetarët mund të kontaktojnë PSRK-në për një sërë kërkesash, si për raporte dhe publikime, ose për propozime intervistash. Nëse ata mbulojnë tema që lidhen me PSRK-në, si zhvillimet që kanë të bëjnë me këtë institucion, ose nëse janë duke shkruar një histori lidhur me PSRK-në, mund të kërkojnë përgjigje me shkrim ose të kërkojnë një koment. Gjithashtu, ata mund të kërkojnë që PSRK-ja të japë një koment gjatë një interviste në transmetim, nëse kjo është e nevojshme për mbulimin e lajmeve që përfshijnë përgjegjësitë e PSRK-së.

Hapat që duhen ndjekur kur bëni një koment me shkrim:

- Zbuloni se kur dhe ku do të publikohet përgjigja
- Zbuloni se cili është afati i fundit i gazetarit (d.m.th. kur i duhet komenti)
- Kërkoni çdo detaj të në lidhje me historinë që po shkruajnë
- Sqaroni çdo gjë që është e paqartë në lidhje me atë që po shkruajnë ose çfarë u nevojitet nga PSRK-ja
- Konsultohuni me kolegët sipas nevojës dhe më pas konfirmoni me gazetarin që së shpejti mund të ju përgjigjeni brenda afatit të tyre (ose e në të kundërtën)
- Kontrolloni nëse kërkesa është bërë më herët. Nëse po, shih nëse dhe përgjigja e dhënë më herët është ende relevante, përditësoni sipas nevojës dhe ndajeni me gazetarin.
- Nëse jo, përgatitni një përgjigje: të përditësuar, lehtësisht të kuptueshme, të saktë dhe të verifikuar, duke përfshirë çdo rast studimor ose statistikë që duhet shtuar. Komenti duhet të ketë tre mesazhe kyçe.

Hapat që duhen ndjekur nëse kërkesa është për një intervistë në transmetim:

- Pyetni nëse intervista do të jetë drejtpërdrejt apo një regjistrim paraprak.
- Nëse regjistrimi paraprak është i disponueshëm, zbuloni se kur mund të bëhet regjistrimi dhe kur duhet të bëhet.
- Verifikoni kur dhe ku do të transmetohet intervista.
- Konsultohuni me kolegët sipas nevojës dhe më pas konfirmoni me gazetarin se zëdhënësi mund të marrë pjesë në intervistë (ose e kundërta).
- Kontrolloni nëse hetimi është kryer më parë. Nëse po dhe përgjigja është ende relevante, përditësoni informacionin sipas nevojës dhe përdoreni atë si pjesë të përgatitjes për intervistën.
- Rishikoni pyetjet e mundshme dhe analizoni thellësisht temën për të cilën gazetari ka interes. Përgatitni përgjigje të qarta, të përditësuar, të shkurtra dhe të verifikueshme, duke përfshirë çdo shembuj studimor ose statistika që duhen përmendur. Komenti duhet të ketë tre mesazhe kryesore, ndërsa shënimet e përgatitjes për intervistën duhet të mbulojnë edhe pyetje të tjera të mundshme që mund të lindin.

5. Zgjidhjet: në praktikë

A. PUNËT E ZAKONSHME

KOMUNIKIMI NË BAZA JAVORE

Komunikimet e rregullta, të përditshme të PSRK-së duhet të shkojnë gjithmonë drejt arritjes sa vijon (siç është theksuar më parë në strategji):

- Shpërndarja e mesazheve kyçe
- Shfaqja e ndikimit dhe progresit të arritur nga PSRK
- Forcimi i marrëdhënieve dhe angazhimit me median.

Për të arritur këto objektiva, informacioni për punën e PSRK-së duhet t'i jepet zëdhënësit (nga prokurorët dhe administratori). Më pas, zëdhënësi mund të lëshojë mesazhet dhe përmbajtjen e duhur për audiencën e duhur në kohën e duhur.

Idealisht, PSRK-ja duhet të ndajë komunikata të rregullta javore me gazetarët dhe në mediat sociale, për zhvillimet kryesore të ndara të hënën dhe të premten, dhe përditësimet ad hoc të ofruara gjatë javës sipas nevojës.

- Buletinet/deklaratat/deklaratat për shtyp të hënën dhe të premten në faqen e internetit
- Buletinet/deklaratat/deklaratat për shtyp të hënën dhe të premten dërguar me email gazetarëve
- Të hënën dhe të premten postime në Facebook/media sociale që nxjerrin në pah atë që publikohet në buletinet
- Njoftimet për shtyp dhe deklaratat ad hoc të shpërndara sipas nevojës gjatë gjithë javës.

Takime mujore të komunikimit

Agjenda e komunikimit në baza mujore mund të vendoset më së miri gjatë një takimi të brendshëm mujor. Për përditësimet javore, zëdhënësi dhe prokurorët mund të takohen për pesë minuta sa herë që kanë kohë të lirë nga agjenda e prokurorëve – qoftë një me një ose në grup.

Takimet e komunikimit duhet të mbahet çdo muaj:

- Në të duhet të marrin pjesë zëdhënësi, udhëheqësit e departamenteve, administratori, bashkëpunëtorët profesional sipas rastit dhe Kryeprokurori sipas rastit.
- Palët kryesore që nuk mund të marrin pjesë duhet të ndajnë një përditësim me shkrim me zëdhënësin përpara takimit.
- Takime duhet të mbulojnë si vijon:
 - Rishikim i aktivitetit të vazhdueshëm në të gjithë institucionin.
 - Komunikime proaktive
 - Identifikoni materialet që mund të jenë të përshtatshme për komunikim dhe që mund të tërheqin vëmendjen e publikut.
 - Identifikoni se cilat nga këto materiale mund të shpërndahen ligjërisht me publikun.

- Për materialet që nuk mund të shpërndahen ligjërisht, por që mund të ngjallin interes, përgatitni përgjigje të mundshme për pyetje të mundshme.
- Për materialet që mund të shpërndahen ligjërisht dhe që janë potencialisht të përshtatshme për komunikim, identifikoni përmbajtjen që është në interes të publikut. Punoni me këtë listë për të selektuar materialin më të rëndësishëm dhe të përshtatshëm për t'u shpërndarë, duke siguruar që përmbajtja është e vlefshme dhe relevante për publikun.
- Komunikimi reaktiv
 - Rishikoni aktivitetin e komunikimit të jashtëm në lidhje me PSRK-në – komentet, zhvillimet e jashtme, sulmet etj.
 - Identifikoni se cilat prej këtyre zhvillimeve kërkojnë përgjigje nga PSRK:
 - A është pyetur dikush nga PSRK-ja drejtpërdrejt për një çështje për të cilën duhet të jepet përgjigje?
 - A ka ndodhur ndonjë zhvillim në një fushë të ndërlidhur, në të cilën PSRK-ja ka kontribuar, e i cili mund të ofrojë përmbajtje ndihmëse ose informative?
 - A kërkohet ndonjë korrigjim?

Kur zhvilloni materiale komunikimi në përputhje me hapat e mësipërm, proceset e mëposhtme mund të ndihmojnë me qëndrueshmërinë dhe standardizimin.

Pyetjet Themelore

Përpara se të hidhni hapat e parë për sa i përket zgjedhjes dhe përdorimit të mjeteve të komunikimit, është e dobishme të bëni pyetjet e mëposhtme përpara se të filloni:

- Çfarë po përpiqeni të arrini me këtë komunikim dhe/ose çfarë mesazhi po përpiqeni të përcillni?
- Kujt dëshironi t'ia dërgoni këtë mesazh (d.m.th. cilës audiencë të synuar?) dhe çfarë mund të bëni për t'u siguruar që ata ta dëgjojnë atë (d.m.th. çfarë lloj gjuhe? Cilët elementë të tregimit duhet të theksohen? A mund të plotësohet komunikimi me raste studimore, statistika ose komente nga staf/shifra/organizata/institucione të veçanta?)
- Si mund të intensifikohet ndikimi me audiencat e synuara nëpërmjet zbatimit – d.m.th. kur duhet të dërgohet, në cilin format, në cilën platformë?

Hapat praktik për projektimin e proceseve të komunikimit

- Krijoni një grup standard komunikimesh përgjatë një afati kohor standard për çdo aktivitet për të cilin është e përshtatshme të komunikohet.
- Çdo fazë në zhvillimin e një rasti, për shembull, duhet të ketë një sërë hapash që duhen ndjekur.
- Për ndonjë arrestim, akuzë/aktakuzë, shpalljen e datave të gjyqimit, fillimin e gjyqimit, çdo ditë/javë të gjyqimit, vendimin, dënimin, ankesën – komunikimet e PSRK-së duhet të ndjekin gjithmonë të njëjtin model.

- E njëjta gjë vlen edhe për:
 - o Hetimet, bastisjet, konfiskimet etj...
 - o Për publikime të një raporti, njoftimi, sondazhi...
 - o Në përgjigje të pyetjeve nga gazetarët.
- Për të gjitha këto raste, duhet të ketë dakordim për sa vijon:
 - o Çfarë lloj komunikatash (një deklaratë për shtyp, një deklaratë me shkrim, një deklaratë para kamerave, një op-ed, një postim në mediat sociale etj) dhe pse.
 - o Ku/si lëshohen këto komunikata (p.sh. përmes emailit në listat mediatike të gazetarëve, të postuara/publikuara në web-faqe, në cilat kanale të mediave sociale etj.)
 - o Kur lëshohen komunikimet – para disa aktiviteteve (dhe sa herët në përputhje me to), në mënyrë simultane me aktivitete të tjera, ose pas ngjarjeve të caktuara (dhe sa kohë pas, duke përfshirë sqarimin e afatit të fundit kur mund të lëshohet një komunikim).
 - o Po ashtu, cilat janë proceset e miratimit të brendshëm për aprovimin e komunikimeve para se ato të shpërndahen.

Lista e Medieve

- Krijoni dhe ruani një listë që përmban detaje të plota të kontakteve dhe adresave të emailit të gazetarëve përkatës, në mënyrë që të mund të dërgoni buletin e së hënës dhe komunikime të tjera me shpejtësi dhe në mënyrë të organizuar.

Kalendarët

- Zhvilloni dhe mbani një kalendar aktiviteteve për koordinimin e brendshëm – rastet dhe pjesët e punës për të cilat jeni në dijeni paraprakisht, publikime, ngjarje, njoftime, etj.
- Hartoni nga kjo një version i cili mund të ndahet me gazetarët – ua jepni të gjithë gazetarëve në listat tuaja të mediave si dokument ose bëjeni të disponueshëm online.
- Në mënyrë ideale, një kalendar mujor ose javor duhet të plotësohet/përditësohet dhe të ndahet me gazetarët në fillim të çdo jave/muaji, në mënyrë që ata të dinë se çfarë po ndodh dhe atë që mund ta mbulojnë potencialisht.

Harrimi i Komunikatave

Lista kontrolluese praktike për hartimin e komunikimeve

- Komunikimet të jenë të qarta, të qasshme dhe të lehta për t'u kuptuar nga të gjithë audiencat e synuara, veçanërisht nga publiku dhe media.
- Gjuha duhet të jetë e thjeshtë, pa motive (d.m.th. neutrale emocionale; e fokusuar në fakte) dhe sa më e lirë nga zhargonet dhe termat teknike. Toni dhe gjuha e duhur do të nënkuptojnë se mesazhet kuptohen dhe përthithen më shpejt dhe plotësisht.
- Çfarë mund t'i shtohet komunikimit për ta forcuar atë në dritën e audiencës së synuar? A do të ishte produktive shtimi i një rasti studimor pozitiv, një statistikë e fuqishme, një citat për një drejtues në një organ tjetër publik ose organizatë të shoqërisë civile, apo për t'i drejtuar lexuesit në mbështetje dhe/ose burime? Këto

janë mënyra të thjeshta për të forcuar një komunikim - për ta bërë atë më të pasur dhe më me ndikim pa u devijuar nga mesazhet kryesore ose pa e zgjatur shumë.

KOMUNIKIMET NË BAZA TRE MUJORE DHE VJETORE

Konferencat për shtyp mund të mbahen si përgjigje ndaj rasteve të ndjeshme ose të profilit të lartë, gjatë situatave të krizave, ose si një reagim ndaj zhvillimeve të rëndësishme. Përveç kësaj, ato mund të planifikohen rregullisht për të promovuar aktivitetet dhe arritjet e PSRK-së, duke mundësuar një angazhim të drejtpërdrejtë me media dhe gazetarë.

PSRK-ja mund të shqyrtojë mundësinë e caktimit të konferencave për shtyp të rregullta, me frekuencë tremujore, dy herë në vit, ose çdo vit, për të realizuar qëllime të tilla si:

- Ndarja e të dhënave statistikore
- Përmbledhja e mesazheve të ndara gjatë komunikimeve javore, të zakonshme
- Përmbledhja e zhvillimeve dhe trajtimit të rasteve të ndjeshme dhe të profilit të lartë
- Sukseset e profilizuara dhe ndikimi
- Parashtrimi i pyetjeve për botime ose arritje/raste specifike.

Udhëzues për konferencën për shtyp

Konferencat për shtyp janë një mjet i vlefshëm për t'iu adresuar temave me profil të lartë, të cilat pritet të shkaktojnë interes të madh publik dhe medial. Duke mbajtur një konferencë shtypi, ju do të keni mundësinë t'u ofroni mediave informacionet kyçe në një kohë dhe vend të përshtatshëm, duke ofruar gjithashtu përmbajtje video incizimi (nëse konferenca është e filmuar) e cila mund të shpërndahet edhe nëpërmjet televizioneve. Gjatë një seance interaktive, do të mund të përgjigjeni pyetjeve të gazetarëve, duke krijuar mundësinë për të formësuar në mënyrë të qartë dhe të vendosur narrativën rreth temës që po trajtohet.

Megjithatë, ndonëse njoftimi për shtyp mund të arrijë një efekt të ngjashëm duke e shpërndarë në të njëjtën kohë përmes mediave të shumta, është e rëndësishme të merrni parasysh kostot dhe burimet që kërkon organizimi i një konference për shtyp. Vlerësoni përfitimet që mund të sjellë një konferencë për shtyp në krahasim me mundësitë e tjera, para se të merrni vendimin për të vazhduar me planet që i keni.

Duhet pranuar gjithashtu se një konferencë për shtyp u jep mundësi gazetarëve të bëjnë pyetje që nuk kanë të bëjnë me temën për të cilën po thirret konferenca, që do të thotë se tema për të cilën është thirrur konferenca mund të vendoset lehtësisht nën hije, nëse ka më shumë çështje aktuale për median. Kjo do të thotë se konferenca mund të thirret për një temë më pak të rëndësishme, ndërsa vetë pjesëmarrësit e konferencës e dinë se mediat do të jenë më të interesuara për përgjigjet në pyetje të tjera më aktuale.

Si rezultat, është thelbësore që përgatitja për çdo konferencë të jetë gjithëpërfshirëse, me folësit që shqyrtojnë dhe zhvillojnë përgjigje për çdo pyetje të mundshme që mund

t'u dalë. Nëse në konferencë dëgjohen pyetje që janë befasuese apo të papritura për pjesëmarrësit e konferencës, kjo do të thotë se konferenca nuk është përgatitur siç duhet.

Ndiqui këto hapa për të koordinuar një konferencë për shtyp:

1. Planifikimi i Konferencës për Shtyp – Zgjidhni kohën dhe vendin e përshtatshëm për mbajtjen e konferencës, duke u siguruar që të jetë vend i përshtatshëm për pjesëmarrjen e gazetarëve
2. Njoftoni dhe ftoni gazetarët të paktën disa ditë përpara se të planifikohet të mbahet konferenca. Nëse arsyeja e konferencës janë aktualitetet ditore, është e nevojshme që njoftimi t'u dërgohet gazetarëve disa orë më herët, në mënyrë që ata të organizohen.
3. Ftesat duhet të dërgohen në mënyrë të plotë dhe të koordinuar me listat e mediave të PSRK-së (p.sh. tabela e gazetarëve), për të siguruar përfshirjen e mediave dhe gazetarëve nga të gjitha fushat e interesit, si ato komerciale ashtu edhe ato politike.
4. Njoftimi për mbajtjen e konferencës për shtyp duhet të përfshijë temën e konferencës, gjegjësisht arsyen se përse po organizohet konferenca, kohën dhe vendin e konferencës, folësit në konferencë dhe detaje të qarta se kush mund të marrë pjesë (d.m.th. nëse lejohen fotografët dhe video-filmuesit).
5. Njoftimi për mbajtjen e konferencës për shtyp duhet të tregojë afatin e fundit për dorëzimin e letrave kredenciale për shtyp (emri dhe mbiemri i gazetarit, kameramanit dhe fotoreporterit, medias).
6. Përpara konferencës, rishikoni mesazhet dhe objektivat kryesore të konferencës dhe sigurohuni që folësit e duhur të jenë caktuar. Folësit dhe pjesëmarrësit duhet të bien dakord për atë që do të thonë dhe për mesazhet thelbësore që do të dërgojnë.
7. Qëllimi i përgjithshëm i konferencës për shtyp në përgjithësi duhet të jetë promovimi dhe prezantimi pozitiv i punës së PSRK-së, por është e dobishme të merret në konsideratë nëse ka pasur sulme të kohëve të fundit dhe të ndërlidhura që mund të kundërshtohen/korrigjohen në mënyrë efektive dhe të shpejtë në kontekstin e konferencës për shtyp.
8. Rishikoni pyetjet e mundshme me folësit dhe sigurohuni që ata të ndihen të përgatitur mirë. Merrni mbështetje për kërkime, informime ose trajnime nga personeli i brendshëm ose organizatat e jashtme aty ku kërkohet dhe është e mundur.
9. Përgatitni një prezantim vizual për të shoqëruar temën e prezantimit, duke ofruar imazhe, infografikë dhe tekst përmbledhës përkatës.
10. Materialet e shkruara duhet t'u shpërndahen gazetarëve gjatë konferencës për shtyp (fjalimi i pjesëmarrësve, të dhënat e shkruara, statistikat, etj.). Kjo do të shmangë mundësinë që gazetari të përcjellë informacione që ai ose ajo i ka dëgjuar gabimisht. Materiali i shkruar mund të përdoret gjithashtu për të prezantuar dhe krijuar lidhje me tema të reja me të cilat gazetarëve do t'u kërkohet të angazhohen në të ardhmen.
11. Është e rëndësishme që pas konferencës të lëshohet një komunikatë për shtyp duke ofruar mesazhe kyçe për mediat që nuk kanë qenë pjesë e konferencës.

Mjetet e komunikimit

PSRK-ja duhet të përdorë rregullisht njoftimet për shtyp, deklaratat përmes faqes së internetit, postimet në Facebook, konferencat për shtyp, paraqitjet publike dhe intervistat e transmetuara për të përcjellë mesazhet e saj tek audiencat e saj kryesore. Megjithatë, nëse zyra ka kapacitet dhe burime për të eksperimentuar me mekanizma alternativë dhe më tërheqës vizualisht për komunikim, mund të synoj të zgjeroj listën e mjeteve të komunikimit që ka në dispozicion.

Cilat janë mjetet e disponueshme për të komunikuar?

- Njoftim për shtyp
- Deklarata ose komente
- Buletinet informuese
- Konferenca për shtyp
- Videoklipe të regjistruara paraprakisht, duke përfshirë prokurorët ose zëdhënësit që flasin para kamerës
- Konferenca për shtyp (ngjarje me prezencë fizike)
- Konferencë për shtyp (dokument i lëshuar në formë dixhitale)
- Seminare, punëtori, konsultime; takime formale dhe joformale
- Raporte dhe publikime
- Broshura dhe manuale
- Buletinet
- Pjesëmarrje në konferenca, debate, tryeza të rrumbullakëta
- Editoriale të opinionëve në median e shkruar, duke përfshirë kolonat, komentet dhe analizat
- Sondazhet
- Infografikë
- Fotografi
- Përbajtje të qasshme për personat me aftësi të kufizuara (përkthim në gjuhën e shenjave, titrim, materiale në shkrim Braille dhe në formë elektronike, etj.).
- Rrjetet/mediat sociale (N.B. si në udhëzimet e mëposhtme, përdorimi/përfshirja e mediave sociale ose përbajtjes së ri-dizajnuar të ueb-it është opcionale dhe do të vepohet pas disponueshmërisë së burimeve/kapacitetit më të madh.)
- Web faqja, faqet e internetit.

B. KOMUNIKIMET REAKTIVE: PËRGJIGJE NDAJ SULMEVE DHE DEZINFORMIMIT

Siç është theksuar në seksionin "sfidat e jashtme" të kësaj strategjie, agjendat politike dhe shprehjet e shpeshta (ndër të cilat përfshihen edhe sulme të hapura dhe armiqësore nga disa departamente qeveritare) në media, nënkuptojnë se PSRK-ja shpesh bëhet objekt i kritikave publike që janë të motivuara nga besnikëria politike, dhe jo nga vlerësimi i efektivitetit të punës së zyrës. Kjo mund të ndikojë negativisht

në formimin e opinionit publik, duke përhapur pretendime të pasakta dhe të pabazuara.

Për më tepër, mediat nuk janë plotësisht të pavarura ose të rregulluara në mënyrën e duhur, duke krijuar mundësi për raporte të pasakta ose të njëanshme që mund të bazohen në interesa politike ose komerciale. Ndërkohë që disa media të specializuara janë mirë të informuara për drejtësinë penale dhe sistemin ligjor, mediat në përgjithësi shpesh kanë njohuri të kufizuara mbi funksionet, përgjegjësitë, kompetencat dhe arritjet e PSRK-së, gjë që gjithashtu çon në raportim të pasaktë.

PSRK-ja është e detyruar të mbajë konfidencialitetin dhe të fsheh disa informacione (siç janë detajet mbi rastet e hapura). Megjithatë, në rastet kur zyrat përballen me sulme të pasakta dhe përhapje të dezinformative, PSRK-ja duhet të ndërmarrë hapa për të korrigjuar informacionet, duke siguruar transparencë dhe duke ofruar të dhëna të sakta për publikun, si më poshtë:

Vlerësimi se cilat sulme duhet ti përgjigjeni:

Ekzistenca e dezinformative në hapësirën publike dëmton reputacionin e PSRK-së. Prandaj, shumica e sulmeve duhet të kundërshtohen nëse është e mundur, por jo të gjitha kërkojnë përgjigje ose përgjigje të qëndrueshme/të vazhdueshme.

Përgjigjuni dhe korrigjoni:

- Çdo sulm që jep informacion të pasaktë për raste specifike që po trajton PSRK-ja. Sulmet tjera më pak specifike duhet të trajtohen nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.
- Sulmet personale që komprometojnë aftësinë e një prokurori për të përmbushur punën e tij/kanë lidhje me jetën e tyre profesionale - p.sh. që i akuzojnë për korrupsion, kryerjen e një krimi ose marrëdhënie të papërshtatshme me një koleg, për shembull.
- Sulmet personale që po marrin vëmendje të konsiderueshme të medias vendore.

Mos u ktheni përgjigje:

- Sulmet që nuk kanë të bëjnë me detyrën apo aktivitetin e PSRK-së në ndonjë aspekt kuptimplotë
- Sulmet personale që janë thashetheme të përmasave të vogla që nuk marrin një vëmendje të madhe. Vini re se ju MUND të përgjigjeni nëse ju kërkohet nga një gazetar - d.m.th. të sqaroheni në mënyrë reaguese - por nuk keni nevojë të postoni përgjigje PROAKTIVE

Vini re gjithashtu se nëse nuk është e përshtatshme t'i përgjigjeni një sulmi në atë kohë, mund të mendoni ta trajtoni atë në kontekstin e një konference më të madhe për shtyp, në të cilën qëllimi kryesor i konferencës për shtyp është promovimi pozitiv i punës së PSRK-së, por gjatë së cilës sulmet e ndërlidhura mund të referohen dhe korrigjohen/kundërshtohen.

Nëse sulmet vazhdojnë për të njëjtën çështje, ekzistojnë dy opsione – gjykoni bazuar në ashpërsinë e akuzës / natyrën e detajit (d.m.th. një mund të mos jetë i përshtatshëm)

- Përshkallëzoni gjuhën - përdorni opsionin e gjuhës më të fortë të dhënë më poshtë.
- Referojini njerëzve në bazë të deklaratës origjinale: Përpikuni të mbani komunikimet sa më të thjeshta dhe të kufizuara, duke i referuar audiencës përmes deklaratave origjinale në mediat sociale, në vend që të publikoni përmbajtje të re.
- > “Pas çështjes shtesë të informacionit të pasaktë nga Y në lidhje me X, PSRK-ja i referohet edhe një herë deklaratës së publikuar në datën Z – [jep një lidhje me deklaratën].”
- > Vetëm me email si përsëritje të deklaratës për gazetarët ose hartoni dhe postoni një deklaratë të re nëse sulmet pasuese përfshijnë sasi të konsiderueshme të dezinformatave të reja, që po rriten ndjeshëm ose kaloni në një temë të re duke qenë ende pjesë e për shkëmbimit fillestar

Udhëzime hap pas hapi për përgjigje

1. Verifikoni burimin e sulmit ose dezinformatës dhe përcaktoni platformën në të cilën është shpërndarë informacioni.
2. Monitorimi i platformave përkatëse të komunikimit për të identifikuar çdo koment ose përsëritje të sulmit/dezinformatave në mediat sociale dhe kanalet e tjera mediatike.
3. **Prioriteti i kohës së reagimit: Sigurohuni që PSRK të reagojë sa më shpejt të jetë e mundur, duke sqaruar situatën dhe duke siguruar fakte të sakta, në mënyrë që dezinformatat të mos përhapen dhe të mos përsëriten.**
4. Në bazë të të kuptuarit të situatës, zëdhënësi duhet të përgatisë një korrigjim/përgjigje/deklaratë. Komunikimi duhet të jetë i shkurtër, konciz, i bazuar në fakte dhe neutral në ton, sipas udhëzimeve në seksionin "neutraliteti tonal" në këtë strategji.
5. Më pas, zëdhënësi duhet t'ia shpërndajë këtë personelit përkatës për shqyrtim dhe të konfirmojë saktësinë teknike dhe korrektësinë e përmbajtjes, duke u siguruar se është faktikisht i saktë dhe nuk zbulon asnjë informacion konfidencial që nuk duhet të publikohet.
6. Pasi të nënshkruhet nga Kryeprokurori, deklarata duhet të postohet sa më shpejt që të jetë e mundur në faqen e PSRK-së dhe në Facebook/shpërndarë në mediat sociale.
7. Nëse sulmi është i rëndësishëm ose është marrë tashmë nga media vendore, deklarata mund t'u dërgohet me email edhe gazetarëve në listën e mediave të lartpërmendur të PSRK-së. Nëse përfshin një akuzë në shkallë të vogël dhe nuk ka gjasa të raportohet nga media, shmangni nxitjen e shkëmbimit duke njoftuar gazetarët përmes emailit dhe thjesht postoni në faqen e internetit të PSRK-së dhe mediat sociale.
8. Sigurohuni që detajet e kontaktit për zëdhënësin (email dhe linjë direkte telefonike) të figurojnë në deklaratë, në faqen e internetit dhe në email nëse del jashtë institucionit.

Përgjigjet ndaj sulmeve: opsionet e shablloneve për deklaratat e shkruara

Një përgjigje e matur dhe teknike që është ende e fuqishme - për përdorim në rastin e një sulmi që kërkon një përgjigje, por nuk është jashtëzakonisht nxitëse.

“Prishtinë, 30 tetor 2024 – Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK) sot duhet të bëjë një korrigjim pas shpërndarjes së informatave të pasakta nga [pala/organi sulmues]. Deklarata e ministres së Drejtësisë Albulena Haxhiu për PSRK-në është e pasaktë, dhe si rrjedhojë, i mashtron dhe dezinformon qytetarët për një çështje të rëndësishme të interesit publik.

Në orën X sot, ministrja e Drejtësisë Albulena Haxhiu ka ndarë shqetësimet për rastin dhe ka lëshuar një deklaratë duke thënë se “janë të shqetësuar pasi Prokuroria Speciale ka mbyllur hetimet për rastin e pronës milionëshe në Veternik”. PSRK-ja mund të konfirmojë se rasti Veterniku” është jashtë juridiksionit të saj sepse rasti ka të bëjë me [xxxx]. Prandaj ky rast nuk është dhe asnjëherë nuk ka qenë nën kompetencën e PSRK-së, dhe si rezultat nuk është hetuar nga PSRK-ja.

Pas nevojës për korrigjimin e këtij dezinformimi, PSRK-ja inkurajon partnerët dhe bashkëpunëtorët e respektuar që të veprojnë në frymën e bashkëpunimit që kërkohet për mbrojtjen efektive të qytetarëve të Kosovës.

Kemi kënaqësinë të sigurojmë publikun se PSRK-ja mbetet një burim i besueshëm i informacionit të saktë dhe se është e përkushtuar për luftimin e krimit të organizuar dhe vënien para drejtësisë të autorëve të krimit të rëndë dhe të organizuar, korrupsionit dhe krimit financiar, terrorizmit dhe krimeve të luftës. [ose shtoni ndonjë informacion tjetër relevant në lidhje me punën e PSRK-së].

Për të mësuar më shumë rreth punës së PSRK-së, vizitoni faqen tonë të internetit [këtu](#).

Një përgjigje ekstra e fuqishme me gjuhë të shtuar për sulmet më të tmerrshme

“Data - Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK) shpreh keqardhje të thellë që sot duhet të deklarohet që të adresojë shpërndarjen e dezinformatave serioze tek publiku kosovar nga [x parti/individ/institucion].

Në një [intervistë/deklaratë/etj] që komprometon të drejtat e qytetarëve për informacion të saktë për institucionet dhe përfaqësuesit e tyre publik, në datën X [x parti/individ/institucion] mashtroi elektoratin kosovar për një çështje të rëndësishme me interes publik duke thënë X. Kjo është e pasaktë sepse...

PSRK është e shqetësuar që, edhe një herë, është e detyruar të ndërmarrë hapa për të siguruar mirëkuptimin e publikut për operacionet dhe aktivitetet e rëndësishme, duke korrigjuar informacionin e dhënë. Ajo u bën thirrje partnerëve dhe bashkëpunëtorëve të saj të nderuar që të adoptojnë një qasje bashkëpunuese, e cila është thelbësore për mbrojtjen efektive të qytetarëve të Kosovës.

Kemi kënaqësinë të sigurojmë publikun se PSRK-ja mbetet një burim i besueshëm i informacionit të saktë dhe se është e përkushtuar për luftimin e krimit të organizuar dhe vënien para drejtësisë të autorëve të krimit të rëndë dhe të organizuar, korrupsionit

dhe krimit financiar, terrorizmit dhe krimeve të luftës. [ose shtoni ndonjë informacion tjetër relevant në lidhje me punën e PSRK-së].

Për të mësuar më shumë rreth punës së PSRK-së, vizitoni faqen tonë të internetit [këtu](#).

Një përgjigje ndaj një sulmi personal (përgjigje e lëshuar nëse ata po dominojnë median ose nëse kanë ndikim në një rast).

“Data – PSRK-ja sot lëshon deklaratë për të korrigjuar informacionet e pasakta që janë shpërndarë në lidhje me X.

Raportet kanë gabuar [tha xyz], por PSRK mund të konfirmojë se kjo është e pasaktë dhe se [shpjegoni përgjigjen e saktë].

PSRK punon në interes të publikut dhe merr vendime ekskluzivisht sipas standardeve etike dhe profesionale, kushtetutës dhe rregulloreve ligjore. Detyra e saj kryesore është të luftoj krimin e organizuar dhe të sjellë para drejtësisë autorët e krimit të rëndë dhe të organizuar, korrupsionit dhe krimit financiar, terrorizmit dhe krimeve të luftës. PSRK punon për të garantuar sigurinë e të gjithë qytetarëve përmes mbrojtjes efikase dhe cilësore të sigurisë së tyre dhe të drejtës së tyre për të jetuar në një shoqëri të lirë nga krimi i organizuar, korrupsioni i nivelit të lartë, pastrimi i parave, krimet e luftës dhe terrorizmi.

PSRK-ja i kushton vëmendjen e plotë përmbushjes së funksioneve të saj kryesore dhe vazhdon t'i shërbejë interesit publik me përkushtim, transparencë, pavarësi dhe autoritet. Ajo inkurajon partnerët dhe bashkëpunëtorët e saj të respektojnë që të veprojnë në frymën e bashkëpunimit të kërkuar për të mbrojtur në mënyrë efektive qytetarët e Kosovës.

Për të mësuar më shumë rreth punës së PSRK-së, vizitoni faqen tonë të internetit [këtu](#).

C. KOMUNIKIMI I RASTEVE TË NDJESHME DHE TË PROFILIT TË LARTË

Rastet e ndjeshme dhe të profilit të lartë (një shembull i fundit është dhënë nga sulmi në Banjska në 2023) kërkojnë trajtim të kujdesshëm për shkak të sfidave të shumta që ato paraqesin: rastet që ka të ngjarë të tërheqin vëmendje të konsiderueshme janë gjithashtu rastet a) që ka të ngjarë të ndajnë opinionin/shkaktojë polemika dhe b) për të cilat PSRK duhet të ruajë dhe të fshehtë informacionin kyç, të kërkuar.

Shumë nga të njëjtat parime këtu zbatohen edhe kur bëhet fjalë për komunikimet në raste krizash të një shkalle më të gjerë, kështu që disa nga materialet e mëposhtme përsëriten në kontekstin e udhëzuesit gjithëpërfshirës të komunikimit në raste krize, e të cilat janë dhënë në fund të kësaj strategjie.

Kur hartoni komunikim që kanë të bëjnë me raste të ndjeshme dhe të profilit të lartë, përafroni aktivitetin dhe qasjen me parimet e mëposhtme:

Saktësia, efikasiteti dhe afati kohor

Ky parim nënkupton komunikimin në kohë të informacionit të saktë dhe të verifikuar. Nëse dikush vonon komunikimin e informacionit të saktë, i lë hapësirë dhe kohë mediave që të marrin informacion jo të plotë në mënyra të tjera, me ndihmën e burimeve të tyre, gjë që mund ta thellojë më tej krizën.

Publiciteti dhe të qenit të hapur

Një parim tjetër që zbatohet edhe në komunikimin në raste krize, është publiciteti dhe sinqeriteti, që nënkupton se të gjitha mediave, pa diskriminim dhe pa favorizime, duhet t'u jepet qasje në informacion. Ky informacion duhet të komunikohet në mënyrë të thjeshtë dhe të kuptueshme, të jetë i paqartë dhe plotë. Është më mirë të thuash dy fjali plotësisht të qarta sesa dhjetë fjali që mund të keqinterpretohen.

Natyrisht, ky parim përjashton informacionin që nuk mund të zbulohet për shkak të kufizimeve ligjore, në atë pikëpamje se edhe ky kufizim duhet të shprehet dhe shpjegohet qartë.

Mbrojtja e informacionit konfidencial

Mbrojtja e informacionit konfidencial, si parim, zbatohet për të gjitha llojet e komunikimit, duke përfshirë komunikimin në raste krizash, që do të thotë se komunikimi në ZPS bëhet në atë mënyrë që informacioni i shënuar me një nivel të caktuar konfidencialiteti të mos i vihet në dispozicion personave të paautorizuar.

Edhe në rastin e informacionit konfidencial, është e nevojshme të shpjegohet se një informacion i tillë është konfidencial, domethënë se ka arsye pse ai nuk mund të zbulohet.

Prezumimi i Pafajësisë

Një parim i rëndësishëm i komunikimit ka të bëjë me respektimin e prezumimit të pafajësisë. Ky parim nënkupton që të gjithë në PSRK duhet të sigurojnë që deklaratat e tyre për të pandehurin, veprën penale dhe procedurën të mos cenojnë të drejtën e të pandehurit për t'u konsideruar i pafajshëm derisa të vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë.

Komunikimi i planifikuar

Komunikimi i PSRK-së kryhet në mënyrë të organizuar, sipas një plani të paracaktuar, i cili mund të zhvillohet duke përdorur këtë udhëzues.

E drejta e publikut për të ditur dhe ligjshmëria

Duke folur për veprimet e PSRK-së, është gjithmonë e rëndësishme të arrihet një ekuilibër ndërmjet të drejtës së publikut për të ditur dhe mbrojtjes së ligjshmërisë së vetë procedurës penale. Për këtë arsye, parimet e PR në raste krize të PSRK-së ndryshojnë nga parimet e PR të rasteve të krizave të organizatave të tjera.

Një shënim për afatet kohore dhe deklaratat e mbajtur

Mbani mend, gjithmonë mund të thoni "Ne do të ofrojmë informata të përditësuara deri në orën/datën X ose "sa më shpejt të jetë e mundur", edhe nëse nuk jeni në gjendje të jepni më shumë informacion. Krijimi i kontakteve, të folurit dhe të dëgjuarit është kritike për blerjen e kohës dhe ndërtimin e kontrollit të situatës nga PSRK.

- Parimi më i rëndësishëm i komunikimit në raste krize i referohet shpejtësisë së reagimit. Është shumë e rëndësishme të reagoni menjëherë ndaj një krize kur ato tashmë kanë ndodhur. Nuk guxon të lejohet që opinioni publik të krijoj mendimin e tyre pa komunikim nga PSRK-ja.
- Veprimi duhet të jetë i shpejtë: lajmet përmes mediave sociale dhe portaleve përhapen me shpejtësi dhe pritja mund të dëmtojë PSRK-në sepse heshtja mund të keqinterpretohet dhe vetë heshtja bëhet lajm negativ për PSRK-në.
- Nëse kontakti me median nuk vendoset sa më shpejt që të jetë e mundur, për të dhënë informacion bazë, ekziston rreziku që publiku të krijoj imazhin e një institucioni të paafte që nuk di të përballlet me situatën në fjalë.
- Asnjë informacion, nuk ofron bazë për pretendime se PSRK-ja qëllimisht po i fsheh informatat dhe në këtë rast mediat kërkojnë një burim tjetër informacioni që jo domosdoshmërisht është në favor të PSRK-së.
- Heshtja në raste të tilla pasqyron gjithmonë pasigurinë e një institucioni që nuk ka kontroll mbi ngjarjet dhe nuk synon ti marrë nën kontroll.
- Kushdo që mendon se në një krizë duhet të heshtë dhe të mbështetet në faktin se publiku do të harrojë një situatë të caktuar, duhet ta dijë me kohë se kjo është një strategji e gabuar komunikimi.
- Ekziston një rregull për komunikimin në raste krizash: **Nëse nuk komunikoni, publiku mendon se po fshihni diçka. Sa më shumë që flisni (mesazhe të paracaktuara sipas planit të vendosur) - publiku e humbet interesin më shpejt.**
- Është e detyrueshme të thuash të vërtetën dhe të pranosh përgjegjësinë për veprimet e dikujt sepse një gjë e tillë rrit besueshmërinë e institucionit.
- Nuk duhet të themi gjithçka, por gjithçka që themi duhet të jetë e saktë, e verifikuar dhe e provuar.

Udhëzues hap pas hapi: trajtimi i komunikimeve të ndjeshme, të rasteve të profilit të lartë

A. Faza fillestare: komunikimet e para

1. Sigurohuni që prokurorët dhe personeli kanë gatishmërisë për t'i ofruar zëdhënësit informacione të përditësuara.
2. Ofroni kuptim të plotë të asaj që mund dhe nuk mund të zbulohet publikisht (nga një këndvështrim teknik dhe ligjor) në fazat e hershme të çështjes.
